



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



INSTITUTI I STATISTIKAVE



AUTORITETI KOMBËTAR
PËR
SIGURINË KIBERNETIKE

Nr. 1684 Prot.

Tiranë, më 23.09.2025

Nr. 2670 Prot.

Tiranë, më 23.09.2025

MARRËVESHJE

Lidhur sot në datë 23.09.2025, në Tiranë, ndërmjet:

- **AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE**, këtu e në vijim i quajtur “AKSK”, me adresë: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr.3, Tiranë, përfaqësuar nga **Z. Igli Tafa, Drejtor i Përgjithshëm**,

Dhe

- **INSTITUTIT TË STATISTIKAVE**, këtu e në vijim i quajtur “INSTAT”; me adresë Rr: Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017, përfaqësuar nga **Elsa Dhuli, Drejtore e Përgjithshme**

Duke pranuar se Teknologjitë e Informacionit dhe të Komunikimit (TIK) kanë hapur dritare të reja mundësish dhe janë mjete thelbësore për zhvillimin socio-ekonomik;

Duke pranuar se TIK kanë sjellë gjithashtu lloje të reja kërcënimesh si: krimi kibernetik, spiunazhi kibernetik, aktivizimi, terrorizmi kibernetik, lufta kibernetike, sulmet ndaj infrastrukturës kritike, fushat e dezinformimit; dhe se këto kërcënime janë në rritje globalisht, ndërkombëtarisht, në mënyrë dinamike dhe po shfaqen gjithnjë e më të sofistikuar;

Duke pranuar se INSTAT për shkak të veprimtarisë që kryen, e ka të domosdoshme rritjen e vigjilencës në kuadër të mbrojtjes së sistemeve të informacionit ndaj incidenteve kibernetike.



Nga ana tjetër, AKSK si Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, është dakord të bashkëpunojë me INSTAT sipas kërkesës së tij për kryerjen e monitorimeve të vazhdueshme me qëllim parandalimin e veprimeve keqdashëse si dhe dhënien e asistencës së nevojshme për rritjen e ndërgjegjësimit dhe shtimit të vigjilencës në fushën e sigurisë kibernetike.

Atëherë për sa më lart, Palët bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje sipas termave dhe kushteve të mëposhtëme:

Neni 1

QËLLIMI

Kjo Marrëveshje ka për qëllim të promovojë bashkëpunimin në fushën e sigurisë kibernetike ndërmjet Palëve si dhe të përmirësojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre në lidhje me sigurinë kibernetike bazuar në specifikimet sipas Nenit 3 të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.

Neni 2

STATUSI I MARRËVESHJES

Kjo Marrëveshje si dhe ligji nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike” (më poshte referuar “ligji”) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij përcaktojnë kornizën brenda të cilës Palët synojnë të bashkëpunojnë për të arritur qëllimet e përcaktuara në këtë marrëveshje.

Neni 3

FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

Për të arritur qëllimin e mësipërm të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi përveçse sa parashikuar në ligj, Palët synojnë të bashkëpunojnë si vijon:

- Kryerjen e monitorimit aktiv nga AKSK nëpërmjet informacioneve të marra nga platforma e brendshme si dhe të testimit të brendshëm, me qëllim evidentimin e parandalimin e veprimeve keqdashëse.

Neni 4

SHKËMBIMI DHE PËRDORIMI INFORMACIONIT

1. Palët marrin përsipër të shkëmbejnë informacionin për qëllimet e kësaj Marrëveshje duke ruajtur Konfidencialitetin. Shkëmbimi i informacionit sipas kushteve të kësaj Marrëveshje, do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, politikat dhe mekanizmat në fuqi të palëve.



2. Asnjëra palë nuk do të shpërndajë informacionet e marra nga Pala tjetër sipas përcaktimeve të kësaj Marrëveshje, te asnjë palë të tretë pa pëlqimin paraprak të Palës tjetër.
3. Palët do të zbatojnë mbrojtjen e të dhënave personale, sipas kuadrit ligjor në fuqi.
4. Palët do të caktojnë një person kontakti përgjegjës për komunikimet ndërmjet Palëve në kuadrin e kësaj marrëveshjeje.
5. Çdo aktivitet i përbashkët që përfshin pronësinë intelektuale do të dakordësohet me shkrim nga Palët për të mbrojtur interesat përkatëse.

Neni 5

FILLIMI, KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dyja Palët.
2. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet për një afat të pacaktuar dhe secila nga Palët mund ta ndërpresë atë në çdo kohë duke njoftuar palën tjetër me shkrim të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara.
3. Kjo Marrëveshje mund të modifikohet me marrëveshje reciproke me shkrim të Palëve.
4. Një modifikim i kësaj marrëveshjeje do të hyjë në fuqi në datën e përcaktuar reciprokisht nga Palët.

Neni 6

KOSTOT, SHPENZIMET DHE BURIME

Çdo Palë merr përsipër shpenzimet e veta personale dhe i siguron vetes burime për ekzekutimin e kësaj marrëveshje dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të. Të gjitha aktivitetet sipas kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi do t'i nënshtrohen disponueshmërisë së burimeve financiare dhe njerëzore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

INFORMACIONET E KONTAKTIT



AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE	INSTAT
Emër:	Emër:
Institucioni: AKSK	Institucioni:
Telefon: +355 4 22 210 39	Telefon:
Adresë e-mail:	Adresë e-mail:
Telefon24/7: +355 4 22 210 39	Telefon24/7:
Telefon emergjencash:	Telefon emergjencash:
Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II", Tiranë	Adresa: Rr: Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017

Neni 8


DISPOZITA TË FUNDIT

Kjo Marrëveshje hartohet në 2 (dy) kopje të barasvlershme në gjuhën shqipe, nga 1(një) kopje për secilën palë.

Nënshkruar në Tiranë, më datë 23.09.2025.

**PËR
AUTORITETIN KOMBËTAR
PËR
SIGURINË KIBERNETIKE**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Z. IGLI TAFA**


NËNSHKRIMI



**PËR
INSTITUTIN E STATISTIKAVE
DREJTORE E PËRGJITHSHME**

Elsa DHULLI
NËNSHKRIMI

